



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
MINISTRI

U-POLIS  
NR. 64 / 16. Prot.  
Dt. 24.05.2016

Nr. 5237 Prot.

Tiranë, më 20.05 2016

**URDHËR**

Nr. 266, datë 20.5.2016

**"PËR  
AKREDITIMIN PERIODIK TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË  
DYTË, "MASTER I SHKENCAVE I INTEGRUAR" NË "PLANIFIKIM DHE  
MENAXHIM URBAN", TË FAKULTETIT "PLANIFIKIM, MJEDIS DHE  
MENAXHIM URBAN", TË UNIVERSITETIT "POLIS"**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 138 të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimit nr. 424, datë 28.4.2010 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë", i ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të dytë, "Planifikim dhe Menaxhim Urban", në Fakultetin "Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban", të Universitetit "Polis", që realizohet me 300 kredite, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje 5 vite akademike/10 semestra, në përfundim të të cilës lëshohet diplomë universitare "Master i Shkencave i Integruar" në "Planifikim dhe Menaxhim Urban".
2. Ky program studimi akreditohet në bazë të Vendimit nr. 121, datë 18.02.2016, të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bashkëlidhur këtij urdhri.
3. Ngarkohet Inspektorati Shtetëror për Arsimin dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe Universiteti "Polis".

*Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren Zyrtare".*

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

